

VENDIM
Nr. 109, datë 22.4.2021

**MBI KËRKESËN E OSSH SHA, LIDHUR ME VENDIMIN E ERE-s NR. 60, DATË
25.2.2021**

Në mbështetje të nenit 20, germa “ë”, nenit 81, pika 3, germa “ç”, nenit 94, pika 2, germa “b” dhe “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 16, nenit 20, nenit 17, pika 1, germa “ë”, nenit 96, pika 11, nenit 98, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 42, 54 dhe 55, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 15 dhe 26, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; “Rregulloren mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë”, miratuar me vendimin nr. 162, datë 20.10.2020, të Bordit të ERE-s; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/4 prot., datë 20.4.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me vendimin e ERE-s nr. 60, datë 25.2.2021”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 218, datë 15.12.2020, Bordi i ERE-s ka filluar procedurën për miratimin e “Standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.

- Përmes shkresës nr. 1315 prot., datë 30.12.2020, ERE ka kërkuar nga palët e interesit: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Furnizuesi i Shërbimit Universal, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike, Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Mirëqenies Sociale, Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Avokati i Popullit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Shoqata e Konsumatorit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të shprehnin opinionet dhe komentet e tyre mbi draft-Rregulloren, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

- Rregullorja për të cilën Bordi i ERE-s ka filluar procedurën është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s: www.ere.gov.al, në zërin “Konsultime”, si dhe bërë me dije në regjistrin e vendimeve të ERE-s për vitin 2020, publikuar në zërin “Vendime”. Vendimi nr. 218/2020 është publikuar gjithashtu në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 8.1.2021.

- OSSH sh.a., me shkresën nr. 2617/1 prot., datë 23.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 435/1, datë 23.3.2021, ka paraqitur kërkesën për ushtrimin e së drejtës për t’u shprehur në cilësinë e palës së interesuar, lidhur me këto standarde, si dhe rishikimin e tyre nëse do të rezultojë e nevojshme, duke konstatuar gjithashtu se si afektohet nga ky akt rregullator.

- Neni 54, pika 1, e Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: “...pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv”, ndërkohë që neni 55, pika 2, parashikon se: “depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të shoqërisë OSSH sh.a., për përcjelljen e mendimeve apo objeksioneve në lidhje me “Rregulloren e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.

2. Pezullimin e zbatimit të afateve të parashikuara në vendimin e ERE-s nr. 60/2021, “Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”, për shoqërinë OSSH sh.a., për një periudhë 45-ditore nga marrja dijani e këtij vendimi.

3. Shoqëria OSSH sh.a. të përcjellë në ERE qëndrimin apo propozimet e saj për ndryshime në “Rregulloren e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”, brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti